

forcave rezervë të policisë në vitin 1992. Në fund të muajit korrik të vitit 1998, Srećko shkoi për të parën herë në Kosovë. Ka qenë i stacionuar në Fabrikën e Municionit në periferi të **Skënderajt/Srbica**. Rreth orës 18:00, më **1.08.1998**, përderisa e mbante rojën me një polic tjetër, drejt tyre kanë shtënë nga armë zjarri. Srećkon e kanë plagosur në tëmbël. E bartën menjëherë me helikopter në AMU në Beograd. Ka ndërruar jetë më 4.08.1998. E kanë varrosur më 6.08.1998 në varrezat e Paunit.

Burimet: deklarata O.S, FDH-30606; USCG KGDH, *Regjistri.*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički.*, III, 430, 936; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 39.

Arife (Bajram Ahmetaj) Balaj

(25.06.1951, shqiptare nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, trembëdhjetë fëmijë)

Arifja ka jetuar me bashkëshortin Avdylin dhe fëmijët. Në datën **2.08.1998**, krismat e armëve të zjarrit nisën të dëgjoreshin që nga mëngjesi, ndërkaq nga ora 12:00 ushtria serbe filloi të depërtonte në fshat. Arifja me familje e braktisën shtëpinë. Iknin me vrap nëpër *Mëhallën Geci*. Avdyli ishte në ballë, ndërkaq Arifja në fund të kolonës. Arritën deri te fshati Rrezallë e Re/Ljudevik. Përderisa po kalonin nëpër fshat, përpara u doli një grup ushtarësh serb. Avdyli nisi të vraponte drejt shtëpive në lagjen *Shatrolli [Rrezallë e Re/Ljudevik]*. Ushtarët shtënë drejt tyre. Një plumb e ka qëlluar Arifen në shpinë dhe e ka lënë të vdekur në vend. Familjarët e kanë mbuluar shpejt trupin e saj me një batanije që e kishin me vete dhe vazhduan të vraponin. Avdyli me farefisën u kthyen në vendin e vrasjes në mbrëmje dhe e varrosën Arifen, jo shumë larg vendit ku ka pësuar. Pas lufte, më 13.11.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Arifes në varrezat e Llaushës/Lauša.

Burimi: deklarata Q.B, FDH-17320.

Hisni (Arif) Gashi

(15.08.1919, shqiptar nga Çabiqi/Čabici, komuna e Klinës/Klina, ekonomist i pensionuar, nëntë fëmijë)

Në muajin korrik të vitit 1998, Hisniu me familjen e vet e braktisën Çabiqin/Čabici [Klinë/Klina]. U strehuan te farefisi në Ujmirë/Dobra Voda [Klinë/Klina]. Në ditën e parë të muajit gusht, Hisniu me djalin Hakiun u kthyen në Çabiq/Čabici. Në mëngjes [**2.08.1998**], rreth orës 04:00, ka filluar sulmi i forcave serbe ndaj fshatit. Djali i Hakiut, Lulzimi, i ka çuar me makinë Hisniun, motrën Sadijen dhe vëllain Gjemajlin deri te tuneli në **Aqarevë/Ovčarevo**, ku më herët ishte strehuar një numër i madh refugjatësh. Rrugës i takuan edhe anëtarë të tjerë të familjes. Para tunelit, Hisniu doli nga vetura, ndërkaq familjarët të tjerë vazhduan. Pas pak, forcat serbe e bombarduan një urë në afërsi. Ciflat e një granate e kanë qëlluar Hisniun dhe e kanë plagosur rëndë në këmbë. Përrjetoi gjakderdhje të madhe dhe shumë shpejtë ndërroi jetë. Në mbrëmje, Lulzimi me kushërinj e kanë bartur trupin e gjyshit në fshatin Tërdec/Trdevac [Glogoc/Glogovac], ku e varrosën një ditë më vonë. Pas lufte, më 11.01.2003, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Hisniut në varrezat e Zabërgjës/Zabrde [Klinë/Klina].

Burimi: deklarata H.G, FDH-17976.

Fatmir (Xhemajl) Veliu

(28.11.1983, shqiptar nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës, civil)

Fatmiri me prindërit Xhemajlin dhe Zojen, si dhe motrat Fetijen dhe Zaden dhe vëllain Xhevatën, jetonin në Polac/Poljance, në lagjen pranë xhamisë së fshatit. Sulmi i forcave serbe ndaj fshatit më 1.08.1998, i ka detyruar Fatmirin dhe familjarët e tij që me bashkëfshatarë të tjerë të strehoheshin në pyllin e afërt. Herët në mëngjes [**2.08.1998**], rifilloi gjëmimi i armëve të zjarrit. Nëna e Fatmirit dhe motra Zadja u nisën drejt pyllit, ndërkaq Fatmiri me të atin dhe motrën Fetijen u vonuan përderisa i përgatisnin disa gjësende. Pastaj, Fatmiri shkoi në ahur, e lëshoi bagëtinë jashtë dhe u nis drejt shtëpisë. Në ato caste, pranë tij dhe në afërsi të derës së shtëpisë ka eksploduar një predhë dhe e ka plagosur atë rëndë në gjoks [**Polac/Poljance**]. E futën shpejt në makinë dhe u nisën drejt Likocit/